

**ROLI I ABDYL FRSHËRIT NË THEMELIMIN DHE PËRFAQËSIMIN  
DIPLOMATIK TË LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT**

**TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE**

**NGA**

**VALON FUGA**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË  
PRISHTINË**

**PRILL, 2023**

## REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS

**Mentori:** *Prof. Dr. Gazmend Rizaj*

**Kandidati:** *Valon Fuga*

**Tema:** *Roli i Abdyl Frashërit në themelimin dhe përfaqësimin diplomatik të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*

Punimi në fjalë trajtonë një temë shumë të rëndësishme “Roli i Abdyl Frashërit në themelimin dhe përfaqësimin diplomatik të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”. Është bërë një përpjekje maksimale që në këtë studim të pasqyrohet drejtë, me objektivitet, pa ndikime dhe duke përdorur metodat adekuate shkencore si: Analizën, Sintezën, Krahasimin, dhe Përshkrimin. Në fillim të këtij punimi, është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të shtruar për studim. Punimi në fjalë përmban tre kapituj:

1. Në kapitullin e parë kemi trajtuar veprimtarin e Abdyl Frashërit në fillimet e Krizës Lindore, duke i shtjelluar disa nga specifikat kyçe të veprimtarisë së tij gjatë kësaj periudhe. Vitet e Krizës Lindore për Shqipërinë në përgjithësi ishin vite të vështira. Gjatë këtyre viteve Abdyl Frashëri hyri si protagonist politik në skenën e historisë së Shqipërisë, kryesisht me një veprimtari më të theksuar në kuadër të Komitetit të Janinës, ku Abdyl hartoi platformën e re politike dhe ideologjike me synimin mbrojtjen e interesave kombëtare të Shqipërisë. Veprimtaria e tij e pa reshtur qëndron edhe në kuadër të Komitetit të Stambollit, i cili ishte edhe njëri ndër protagonistët kryesor të saj, qoftë në veprimtarin e kësaj të fundit por edhe në përpilimin e programit të saj politik e cila është edhe pararendëse e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.
2. Në kapitullin e dytë, është paraqitur ecuria e ngjarjeve dhe rrjedhojat e tyre që kishin ndodhur kryesisht gjatë viteve të Krizës Lindore, gjegjësisht në territorin shqiptar gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX. Një ndër ngjarjet tejet të rëndësishme që kishin ndodhur gjatë kësaj periudhe ishte edhe Traktati i Shën Stefanit dhe qëndrimi

kundër i shqiptarëve ndaj kësaj të fundit ishte e formave të ndryshme. Realisht, këto zhvillime duke përfshirë edhe idenë e thirrjes së një kongresi për të rishikuar Traktatin e Shën Stefanit, bëri që elita shqiptare e kohës duke përfshirë këtu edhe Abdyl Frashërin, të mendojnë për thirrjen e një kuvendi madhorë siç ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Lidhja Shqiptare e Prizrenit, shënon për Abdyl Frashërin, kulmin e veprimtarisë së tij të gjithanshëm në përgjithësi e në veçanti atë politik, diplomatik, kulturor etj.

3. Në Kapitullin e tretë kemi trajtuar, misionin diplomatik të Abdyl Frashërit në kancelaritë evropiane. Qëllimi i tij ishte që të ndikonte tek Fuqitë e Mëdha që të mos zbatohet as traktati i Shën Stefanit e as vendimet e Kongresit të Berlinit. Rëndësia e misionit diplomatik ishte tejet i rëndësishëm, sepse sensibilizimi i çështjes shqiptare për kohën ishte tejet i rëndësishëm. Në fazën e fundit të këtij kapitulli, do të fillojë të elaburojë rendësin dhe specifikat e këtij misioni diplomatik. Edhe pse shumë me vështirësi që zhvilluar si mision, mesazhi i dhënë nga ky i fundit ishte tejet i qartë, njohjen e çështjes shqiptare me të drejtat e saja të plota në arenën ndërkombëtare.

Qëllimi i këtij punimi është analizimi i ngjarjeve që rrjedhën gjatë viteve 1875-1880. Analizimi i këtyre ngjarjeve do të bëhet në bazë të dokumentimit të fakteve me argumente konkrete, të mbështetura në ballafaqimin e ideve të shprehura në botimet e tyre nga autorë të ndryshëm rreth çështjes së rolit të Abdyl Frashërit në themelimin dhe përfaqësimin diplomatik të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gjithashtu për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar një sërë burimesh arkivore të cilat janë marrë nga Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH) si dhe në institucionet e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.